

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"EAGLE LOGISTIC COMPANY" SH.P.K.

Sot, më datë 08/06/2023

Z.**Engjellush Seiti** atesia **Mehmet** amesia **Sherife**, i dl.03/10/1971, lindur ne Diber dhe banues ne Durrës, lagjia Nr.13, plazh, Rruga "Pavaresia", me zotesi te plote per te vepruar, i pajisur me Karte identiteti me ID 038941203 dhe Nr.personal H11003004L.

Ka përpiluar këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare **"EAGLE LOGISTIC COMPANY" SH.P.K.**, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqëria Tregtare **"EAGLE LOGISTIC COMPANY" SH.P.K.**, themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", (këtu e më poshtë Shoqëria).

Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

NENI 2

Emri dhe vula e shoqërisë


Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **"EAGLE LOGISTIC COMPANY" SH.P.K.** Ajo do të ketë edhe vulën e saj.


NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë është:

- Transport te udhetareve e mallrash brenda dhe jashte vendit per vete, per te trete e me qira..
- Veprimtari ne fushen e sherbimeve, ndermjetesim ne tregun e punes, lidhje te kontratave te ndryshme, sherbime logjistike, Agjensi punesimi, Agjensi transporti udhetaresh e mallrash,etj





Shoqëri spedicionere, shërbime spedicionere dhe transporti mallrash të ndryshme brenda dhe jashtë vendit për vete dhe për të tretë.

Agjensi Imobiliare, shitblerje pasuri të luajteshme dhe të paluajteshme, dhënie dhe marrje me qira, asete, pasuri të paluajteshme etj.

- Tregtim me shumice dhe pakice të mallrave të ndryshme industriale.
- Parking automjesh, lavazh, pika servisi, etj
- Për realizimin e qëllimit të saj shoqëria mund të bashkëpunojë me çdo person fizik apo juridik në çdo mënyrë që e gjykon të dobishme.
- Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo lloj aktiviteti të parashikuar nga ligji në përputhje me rregullat e dispozitat në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse të lëshuara nga organet kompetente të fushës.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Shoqëria ka seline ligjore:

Durrës, Lagjia Nr.13, Plazh, Rruga "Pavaresia", Z.K. 8518, Godine me Nr.pasurie 38/82.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie në lekë. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Leke dhe përbehet nga 1 (nje) kuote.

2) Z.Engjellush Selti është zoterues i 1 kuote me 100% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë në vlerën 100.000 leke.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i papërcaktuar dhe fillon me regjistrimin e saj në QKB.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;



2. Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga një Administrator, i cili do të zgjidhet për një afat 5 vjeçar, me të drejtë riemerimi. Administratori i Shoqërisë do të jetë **Z. Engjellush Seiti** pajisur me Kartë identiteti me Nr. H11003004L.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, entit publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori, i cili do të ushtrojë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Ortaku themelues mund të vendosi me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 9

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 10

Ortaku detyrohet të ruajë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhëmbtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 11

Legjislacioni i aplikuar

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortaket e Shoqërisë. Cdo gjë që nuk është parashikuar në Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe nga dispozita ligjore në fuqi.

ORTAKU THEMELUES

Engjellush Seiti





**STATUTI
I
SHOQËRISË**

" EAGLE LOGISTIC COMPANY" SH.P.K.

Sot, më datë 08/06/2023

Z.Engjellush Seiti atesia Mehmet amesia Sherife, i dl.03/10/1971, lindur ne Diber dhe banues ne Durres, lagjia Nr.13, plazh, Rruga "Pavaresia", me zotesi te plote per te vepruar, i pajisur me Karte identiteti me ID ID 038941203 dhe Nr.personal H11003004L

Ka përpiluar këtë Statut të shoqërisë tregtare "EAGLE LOGISTIC COMPANY" SH.P.K., me termat e mëposhtme:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Shoqëria Tregtare "EAGLE LOGISTIC COMPANY" Sh.p.k. rregullon pozitën e saj juridike, marrëdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare, (në vijim Shoqëria).

NENI 1.

Emri dhe selia e Shoqërisë

Shoqëria është Person Juridik Privat. Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin juridik-civil me emërtimin e saj "EAGLE LOGISTIC COMPANY" SH.P.K.

Shoqëria e ka seline **LIGJORE** :

Durres, Lagjia Nr.13, Plazh, Rruga "Pavaresia", Z.K.8518, Godine me Nr.pasurie 38/82.

Shoqëria mund të hapë filiale, dege apo perfaqesi ne te gjithë territorin shqiptar dhe jashte tij.



NENI 2

Objekti i veprimtarisë

- Transport të udhetareve e mallrash brenda dhe jashtë vendit për vete, për të tretë e me qira..
- Veprimtari në fushën e shërbimeve, ndërmjetësim në tregun e punës, lidhje të kontratave të ndryshme, shërbime logjistike, Agjensi punësimi, Agjensi transporti udhëtarësh e mallrash, etj
- Shoqëri ekspedicionere, shërbime ekspedicionere dhe transporti mallrash të ndryshme brenda dhe jashtë vendit për vete dhe për të tretë
- Agjensi Imobiliare, shitblerje pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, dhënie dhe marrje me qira, asete, pasuri të paluajtshme etj.
- Tregtim me shumicë dhe pakicë të mallrave të ndryshme industriale.
- Parking automjesh, lavazh, pika servisi, etj
- Për realizimin e qëllimit të saj shoqëria mund të bashkëpunojë me çdo person fizik apo juridik në çdo mënyrë që e gjykon të dobishme.
- Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo lloj aktiviteti të parashikuar nga ligji në përputhje me rregullat e dispozitat në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse të lëshuara nga organet kompetente të fushës.

NENI 3

Kohëzgjatja e Shoqërisë.

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i papërcaktuar dhe fillon me regjistrimin e saj në QKB.

NENI 4.

Regjimi juridik i Shoqërsë

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut. Ajo respekton parimin e reciprocitetit. Ajo do të organizohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.). Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithëshme, Shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me



dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj. Statuti mund të ndryshojë duke ndjekur normat e mësipërme. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e rregjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

II. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE.

NENI 5.

Ortaku nuk mban përgjegjësi për humbjet e shoqërisë përveç për pjesën e pashlyer të kontributeve të tyre që duhet të derdhen në kapitalin fillestar.

Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Shoqërisë. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qira, të lihen peng e hipotekë me miratimin e Ortakëve.

NENI 6

Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve.

Ortaku jep kontributin e tij në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informon ortakun për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të rastit të sekretit tregtar, i cili është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria mbron, i cili në rast se do t'u përhapej personave të paautorizuar do të shkaktohte dëm të konsiderueshëm interesave tregtarë të shoqërisë.

Ortaku ka të drejtë të heqë dorë nga shoqëria dhe të shesë pjesën e tij të kapitalit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Statut dhe në ligj.

Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron atë nga detyrimet që ata kanë ndaj shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk rrezikon marrjen e të ardhurave nga shoqëria të siguruar deri në atë moment.

Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortaku vepron, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë. Ortaku respekton detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ai përpiqet për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj.





NENI 7.

Abuzimi i ortakut ndaj shoqërisë

Ortaku i shoqërisë tregtare, që kryen një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjet personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tij nëse:

- a) abuzon me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
- b) trajton pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishte pasuria e tij;
- c) në çastin kur merr apo duhet të kishte marrë dënim për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, nuk merr masat e nevojshme, për të siguruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitale të mjaftueshme, për të përmbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.

III. KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË.

NENI 8.

Aktiviteti i Shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë e të tregut. Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

NENI 9.

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakeve themelues të kësaj Shoqërie në lekë. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Leke përbëhet nga 1(nje) kuote,

2) Z.Engjellush Seiti është zoterues i 1 kuote me 100% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë në vlerën 100.000 leke.

NENI 10.

Pronësia mbi kuotat

Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shit-blerjes;



trashëgimisë;

dhurimit;

- në çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.

NENI 11.

Miratimi i Asamblesë së Përgjithshme për fitimin apo kalimin e kuotave.

Pavarësisht nga mënyra e fitimit apo kalimit të kuotave, është i nevojshëm miratimi i Asamblese se Përgjithshme të Ortakeve.

Transferimet e kapitalit themeltar duhet të vërtetohen sipas ligjit, ndryshe janë të pavlefshme.

NENI 12.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asamblea e Përgjithshme me 3/4 e votave.

Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakut.

NENI 13.

Fondet rezerve

Shoqëria disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerien e detyrimeve gjatë veprimtarise së saj.

NENI 14.

Përdorimi i të ardhurave neto.

E ardhura neto që rezultojnë mbasi zbriten shpenzimet e bëra për kryerjen e çdo lloj aktiviteti nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat që rritin kredinë për investime, pagat e shpërblimet, përdoret nga Ortaket sipas qëllimeve të tyre.

NENI 15.

Bilanci, plani financiar.

Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Ortakut ose ekspertëve në momentin e Themelimit të Shoqërisë.



Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

Plani financiar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

NENI 16.

Shpërndarja e fitimeve

Ortakët kanë të drejtë të ndaje pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.

Fitimi i shpërndahet ortakut në raport me kuotat e zotëruara.

NENI 17.

Kufizimi i shpërndarjeve të fitimeve

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitimin ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;

b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e mësipërme.

Kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratori nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

Administratori përgjigjet ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

Administratori, i cili nga pakujdesia lëshon një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjet personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.

Ortaku, që ka marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjet personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u është shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të certifikatës, ky ortak ka patur dijeni për gjendjen e paftësisë paguese të shoqërisë, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për këtë gjendje.

IV. ORGANET E SHOQËRISË.

NENI 18.



Asambleja e Përgjithshme

Organi themelor i shoqërisë është Asamblea e Përgjithshme. Asamblea e Përgjithshme merr vendime të cilat kërkojnë 3/4 e votave në rastet e mëposhtme:

1. ndryshimet e statutit;
2. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
3. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
4. shpërndarjen e fitimeve;
5. raste të tjera të parashikuara nga ligji ose statuti;

për rastet e tjera ajo vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës si më poshtë:

- 1 Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 2 çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 3 përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- 4 emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- 5 emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- 6 përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar.
- 7 mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- 8 miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- 9 pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- 10 përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.

NENI 19.

Asambleja e Përgjithshme është e detyruar dhe me çdo kusht të mbledhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë në rastet e mëposhtme:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.



- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori apo ortaku të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.
- Në rastet e parashikuara në pikën një dhe tre më sipër, përpara Asamblesë së Përgjithshme paraqitet një raport i përgatitur nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.
- Në raste e parashikuara në pikën një dhe tre Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

NENI 20.

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 15 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 21.

Kuorumi i nevojshëm dhe vendim-marrja

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 51% për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.



Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çështjet e tjera, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Çdo kuotë jep të drejtën e një vote. Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

Ortakë, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave.

NENI 22.

Procesverbali i mbledhjes së asamblesë

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

V. ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 23.

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i Emerimit i Administratorëve nuk mund të jete me shume se 5-vjet, me te drejte riemerimi. Emerimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Statuti mund të caktojë rregulla të posacme për emerimin e administratorëve.

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.

Administrator i Shoqërisë do të jetë: Z.Engjellush Seiti, i pajisur me Karte identiteti me Nr. H11003004L, per nje periudhe 5-vjecare.



Shoqëria do të përfaqësohet përpara ç' do organi administrativ, gjyqësor, apo ç' do entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratorët e shoqërisë, të cilët ushtrojnë të drejtat e tyre në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 24.

Të drejtat dhe kompetencat e administratorit


Administratori ka të drejtë të:

1. Te kryej veprime te administrimit të shoqërisë.
2. Te kryej te gjitha aktet administrative te shoqërisë, duke zbatuar politikat tragtare te caktuara nga asambleja e pergjithshme;
3. përfaqësojë shoqërinë tregtare;
4. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
5. përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqesë këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
6. krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
7. kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet ne ligjin për Qendrën Kombetare të Regjistrimit;
8. raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
9. kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Padite, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

VI. PRISHJA E SHOQËRISË. LIKUJDIMI.

NENI 25.



Shoqëria prishet në rast kur:

1. kur mbaron kohëzgjatja e themelimit të saj;
2. me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
3. në rast se objekti bëhet i parrealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
4. në raste të tjera, të parashikuara në statut;
5. në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
6. për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakeve, etj.;

Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit nga Administratorët.

NENI 26.

Likuidimi i shoqërisë

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Çdo person i interesuar, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakëve, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.

Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqëria tregtare prishet me vendim gjykate

Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.

Administratorët e shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Biznesit të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre. Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendrës



Kombëtare të Biznesit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit.

Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë ndiqet nga shënimi "në likuidim". Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj brenda 30 ditëve. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emerimit të tij.

NENI 27.

Të drejtat e detyrimet e likuiduesve

Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

NENI 28.

Bilancet

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 29.

Shpërndarja e aktiveve

Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference. Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli u kthehen ortakëve. Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

VII. DISPOZITA TË FUNDIT.



NENI 30.

Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 31.

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

ORTAKI THEMELUES

Engjellush Seiti

Engjellush Seiti


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS
NOTER FLORIAN F. HOXHA



1200301171040089791

DATE 08/06/2023
NR REP 760

PULLE TARIFE



200+
LEK
R.SHQIPËRIE

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 08/06/ 2023 (Dymijë e njetzet e tre), para meje Noter FLORIAN F. HOXHA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durres, NR.11, ALEKSANDER GOGA, NR.641, NR.27, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT: Engjellush Seiti, atësia Mehmet, amësia Sherife, shtetas Shqiptar, lindur në Bulqizë, Dibër dhe banues në Bulqizë, me adresë Lagjia E Re; Nd. 017; Bulqizë; Bulqizë; 8401; Bulqizë, lindur më 03/10/1971, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038941203 dhe nr. personal H11003004L.

Subjekti i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkruajti përpara meje Noterit, Akt Themelimin dhe Statutin e Shoqërisë "EAGLE LOGISTIC COMPANY shpk" të redaktuar jashtë zyrës noteriale, bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
FLORIAN F. HOXHA